V E N D I M
Nr.74, datë 11.2.1999

PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT, NËPËRMJET MBËSHTETJES SË FORMIMIT INSTITUCIONAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Subjektet, që ofrojnë kurse formimi institucional, në përfundim të të cilave garantohet punësimi i të paktën të 20 për qind të pjesëmarrësve, kanë të drejtë të kërkojnë nga zyra kompetente e punësimit sigurimin e numrit të duhur të kursantëve për shfrytëzimin e kapacitetit të plotë të kursit. Tarifat për kursantët e siguruar në këtë mënyrë paguhen nga zyra kompetente e punësimit.

Për çdo të punësuar mbi numrin e caktuar, subjekti përfiton një shpërblim shtesë deri në tre paga minimale në shkallë vendi. Kushti i punësimit quhet i plotësuar, kur ai realizohet me kontratë të rregullt për një periudhë, të paktën, njëvjeçare dhe sipas profesionit për të cilin u trajnua.

2. Subjektet, që ofrojnë kurse formimi institucional për punëkërkues të papunë nga lista e zyrës kompetente të punësimit, kanë të drejtë të kërkojnë nga kjo zyrë mbulimin e një pjese të kostos së trajnimit për çdo pjesëmarrës në kurs.

Në këto raste, subjektet duhet të argumentojnë, nëpërmjet studimit dhe të analizës së tregut të punës, dobinë social-ekonomike që sjell zhvillimi i kursit. Financimi bëhet kur, të paktën, 60 për qind e kursantëve janë punëkërkues të papunë dhe, në asnjë rast, nuk mbulon më shumë se 60 për qind të kostos së përgjithshme të kursit.

3. Vlerësimi i ofertave dhe i studimeve, sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi, bëhet në përputhje me kriteret e shpallura më parë. Përparësi u jepet kurseve të formimit për profesionet e përcaktuara si parësore në politikat shtetërore të punësimit dhe të formimit profesional dhe që realizojnë punësimin maksimal të mundshëm.

4. Kursantët, punëkërkues të papunë, përfitojnë pagesë pjesëmarrjeje në kurs. Për përfituesit e programeve shtetërore të mbështetjes me të ardhura pagesa shkon deri në nivelin e pagës minimale në shkallë vendi. Për kategoritë e tjera të punëkërkuesve pagesa shkon deri në masën 75 për qind të pagës minimale.

5. Personat, që kundërshtojnë të marrin pjesë në këto kurse, hiqen nga lista e punëkërkuesve të papunë.

6. Fondet e pagesës së papunësisë, të kursyera nga zbatimi i këtij programi, transferohen në masën 100 për qind në buxhetin e shtetit.

7. Për çdo anëtar nga familje që trajtohet me ndihmë ekonomike, buxheti i këtij programi përfiton transferime nga buxheti i ndihmës ekonomike në masën 50 për qind të ndihmës ekonomike të plotë për një familje me 4 persona, për një periudhë të barabartë me periudhën e pjesëmarrjes në kurs.

8. Zbatimi i programit bëhet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të përcaktojë kriteret e detajuara për rastet, si dhe masën e përfitimit nga ky program, dhe mbikëqyr zbatimin e këtij vendimi.

9. Kostoja e këtij programi mbulohet nga fondet e buxhetit të shtetit për nxitjen e punësimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko